

POLITIKA E PRIVATËSISË - FURNITORËT

Ky informacion ofrohet në përputhje me nenin 13 të ligjit 124/2024 për personat që preken nga përpunimi i të dhënave të tyre personale që qëndrojnë në themel të marrëdhënies së furnizimit dhe/ose bashkëpunimit që ekziston me ta.

Ky dokument shpjegon qëllimet dhe metodat me të cilat përpunohen të dhënat tuaja personale, të dhënat personale që përpunohen, të drejtat që kanë subjektet e të dhënave dhe si mund të ushtrohen këto të drejta.

1. Kontrolluesi i të Dhënave dhe Nepunesi për Mbrojtjen e të Dhënave

Kontrolluesi i të dhënave tuaja personale të përmendura në këtë njoftim informativ është shoqeria Engineering Albania Shpk me të cilën ju ose shoqeria juaj keni marrëdhënie kontraktuale furnizimi dhe/ose bashkëpunimi ("**Kontrolluesi i të Dhënave**").

Kontrolluesi i të Dhënave ka caktuar një Nepunespër Mbrojtjen e të Dhënave ose "**DPO**", që mund të kontaktohet në adresën e mëposhtme të email-it: elona.mekshi@eng.it.

2. Kategoritë e të Dhënave Personale të Përpunuara

Kontrolluesi i të Dhënave do të mbledhë dhe përpunojë të dhëna personale të natyrës së zakonshme që lidhen drejtpërdrejt me furnitorin ose me personat përkatës brenda strukturës së tij, si p.sh. bashkëpunëtorët, punonjësit dhe/ose personat e kontaktit të furnitorit.

Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara përfshijnë të dhëna personale (emri dhe mbiemri), të dhëna kontakti (numri i telefonit, adresa e email-it) dhe të dhëna financiare të personave të përfshirë në cilësinë e tyre si persona kontakti në ekzekutimin e marrëdhënies së furnizimit dhe/ose bashkëpunimit — vetëm në masën që këto të dhëna janë të nevojshme për realizimin korrekt të marrëdhënies së përmendur.

Në rastet kur furnizimi dhe ofrimi i shërbimeve zhvillohet në kuadër të kontratave publike, në përputhje me rregulloret përkatëse të prokurimit dhe me qëllim verifikimin e kërkesave të reputacionit të mirë, kërkesave subjektive dhe parakushteve të skualifikimit, mund të mblidhen dhe përpunohen gjithashtu të dhëna gjyqësore (p.sh. certifikata e regjistrimit penal, certifikata e akuzave në pritje, etj.).

3. Qëllimi i Përpunimit dhe Bazat Ligjore

Kontrolluesi i të Dhënave do t'i përpunojë të dhënat tuaja për ekzekutimin e kontratave të furnizimit, për menaxhimin e brendshëm të furnitorëve dhe kontrollin e cilësisë, si dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore që i takojnë Kontrolluesit të të Dhënave.

Të dhënat tuaja personale do të përpunohen:

- a. për qëllimet e **përmbushjes së kontratës** në të cilën subjekti i të dhënave është palë ose për zbatimin e masave kontraktuale paraprake të marra sipas kërkesës së subjektit të të dhënave
- b. për qëllime të kryerjes së aktiviteteve të kujdesit të duhur përpara vendosjes së një marrëdhënieje me Kontrolluesin dhe/ose për futjen, përditësimin apo monitorimin e bazës së të dhënave të furnitorit, qoftë për qëllime të **kryerjes së masave para-kontraktuale**, ose për qëllime të **përmbushjes së detyrimeve ligjore** që i takojnë Kontrolluesit (p.sh. kontabilitet dhe taksa, kundër pastrimit të parave, prokurim, shëndet dhe siguri në punë, etj.), si dhe për qëllime të **përmbushjes së detyrimeve ligjore** që i takojnë Kontrolluesit të të Dhënave (p.sh. kontabilitet dhe taksa, kundër pastrimit të parave, prokurim, shëndet dhe siguri në vendin e punës, për përcaktimin e kërkesave të reputacionit të mirë, si dhe në lidhje me Modelin 231 dhe Kodin e Etikës së Kontrolluesit të të Dhënave)
- c. për menaxhimin e brendshëm të furnitorëve, për përmirësimin dhe rritjen e qëndrueshmërisë së *zinxhirit të vlerës*, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe performancës së tyre. Përpunimi në këtë rast bëhet në ndjekje të **interesit legjitim** të Kontrolluesit për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve të ndërrmarra, përshtatshmërinë e furnitorit dhe angazhimin e tij ndaj standardeve më të fundit të biznesit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe për të identifikuar marrëdhënie të ngushta ndërmjet furnitorëve me qëllim parandalimin e konflikteve të interesit dhe përdorimeve joetike të pozicionit të punës për përfitime personale, në përputhje me procedurat e brendshme dhe Kodin e Etikës.
- d. për qëllime të komunikimit dhe menaxhimit të ngjarjeve të konceptuara dhe/ose të organizuara nga Kontrolluesi (p.sh. dërgimi i komunikimeve lidhur me ngjarjet, publikimi i informacionit), në ndjekje të **interesit legjitim të Kontrolluesit** për të siguruar menaxhimin efektiv të ngjarjeve që synojnë angazhimin e **zinxhirit të furnizimit** të tij mbi tema me interesa të ndryshme (p.sh. sociale)
- e. për qëllime të përcaktimit dhe kryerjes së auditimeve të sigurisë së të dhënave dhe rrjetit, si dhe për parandalimin dhe luftimin e krimeve të mundshme kompjuterike, duke ndjekur kështu **interesin legjitim** të Kontrolluesit të të Dhënave për të ruajtur mbrojtjen e sistemeve të brendshme të IT-së dhe për të zbatuar masa të përshtatshme sigurie, si dhe për të pohuar, ushtruar ose mbrojtur një të drejtë në gjykatë ;
- f. për qëllime të **dërgimit të komunikimeve tregtare dhe/ose promovionale** ndaj subjektit të të dhënave, në lidhje me produktet dhe/ose shërbimet e ofruara nga Kontrolluesi i të Dhënave, për të cilat marrësi ka dhënë pëlqimin e tij/saj . Pëlqimi mund të revokohet në çdo kohë, duke sjellë ndërprerjen e aktiviteteve tregtare dhe promovionale të përmendura më sipër. Revokimi mund të bëhet përmes një komunikimi të dërguar në adresën e email-it: elona.mekshi@eng.it
- g. për qëllime të kryerjes së kërkimeve tregtare, analizave statistikore dhe shërbimeve të ngjashme, në ndjekje të **interesit legjitim** të Kontrolluesit për të mundësuar zhvillimin dhe përmirësimin e aktivitetit të tij të biznesit

4. Përpunuesit e të Dhënave dhe Personat e Autorizuar

Kontrolluesi i të Dhënave do t'i ndajë të dhënat tuaja personale me punonjësit dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët janë identifikuar dhe udhëzuar posaçërisht me akt të shkruar, në përputhje me ligjin 124/2024 ("Personat e Autorizuar"). Këta individë do t'i përpunojnë të dhënat nën autoritetin e Kontrolluesit të të Dhënave, vetëm për qëllimin e kryerjes së detyrave të tyre përkatëse të punës.

Të dhënat tuaja personale mund të ndahen gjithashtu me palë të treta, të cilat janë emëruar me shkrim nga Kontrolluesi i të Dhënave në përputhje me Nenin 26 të Ligjit 124/2024, ose, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi, si kontrollues të pavarur të të dhënave.

Në lidhje me këto kategori marrësish nga palë të treta, specifikohet se të dhënat tuaja mund të ndahen me autoritetet publike vetëm në rastet kur kjo kërkohet nga ligji ose urdhërohet nga autoritetet kompetente.

5. Transferimi i të Dhënave

Në zbatim të qëllimeve të mësipërme, disa nga të dhënat tuaja personale mund të shpërndahen me marrës të vendosur jashtë Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane (BE/EEA).

Në raste të tilla, Kontrolluesi i të Dhënave siguron që transferimi i të dhënave të realizohet në përputhje me dispozitat e Kapitullit IV të ligjit 124/2024.

6. Afatet e Ruajtjes së të Dhënave

Të dhënat tuaja personale do të ruhen duke respektuar plotësisht sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të përdorura për përpunimin e tyre, për aq kohë sa është e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat janë mbledhur.

Në veçanti, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave tuaja do të kryhet në përputhje të plotë me parimet e minimizimit të të dhënave dhe kufizimit të ruajtjes..

.

Përveç kësaj, Kontrolluesi mund të mbajë të dhënat tuaja personale për një periudhë më të gjatë, kur kjo është e nevojshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ligjore që e detyrojnë, ose për të kërkuar, ushtruar apo mbrojtur të drejtat e tij ligjore brenda apo jashtë gjykatës — gjithmonë brenda afateve maksimale të lejuara nga ligji në fuqi.

1. Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ju gëzoni të drejtat e mëposhtme:

- **Aksesi:** ju keni të drejtë të hyni në çdo kohë në të dhënat që lidhen me ju dhe që mbahen

nga Kontrolluesi i të Dhënave, si dhe të merrni çdo informacion të dobishëm lidhur me përpunimin e tyre;

- **Korrigjimi:** ju keni të drejtë të kërkonti dhe të merrni korrigjimin dhe/ose përditësimin e çdo të dhëne të pasaktë që lidhet me ju dhe që mbahet nga Kontrolluesi;
- **Fshirja:** në rrethana të veçanta, ju keni të drejtë të kërkonti dhe të merrni, pa vonesë të panevojshme, fshirjen e të dhënave tuaja personale në posedim të Kontrolluesit;
- **Kufizimi:** në raste të caktuara, ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja;
- **Transportueshmëria:** në rast të përpunimit të automatizuar të të dhënave, të bazuar në pëlqimin tuaj ose në përmbushjen e një kontrate, ju keni të drejtë të merrni të dhënat tuaja personale në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm nga makina, si dhe t'i transmetoni ato te një kontrollues tjetër pa pengesë;
- **Kundërshtimi:** ju keni të drejtë të kundërshtoni në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë, përpunimin e të dhënave tuaja personale të bazuar në ndjekjen e interesave legjitime të Kontrolluesit, përveç rasteve kur ai provon ekzistencën e bazave ligjore bindëse që mbizotërojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja;
- **Vendimmarrja e automatizuar:** ju keni të drejtë të mos i nënshtroheni një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave tuaja, përfshirë profilizimin, kur një vendim i tillë mund të ketë ndikim të rëndësishëm mbi ju.

Ju mund t'i ushtroni këto të drejta, në përputhje me Nenet 14-20 të ligjit 124/2024 duke kontaktuar Kontrolluesin e të Dhënave në adresën e përcaktuar në këtë njoftim ose duke shkruar te DPO-ja në adresën: elona.mekshi@eng.it

Pa cenuar asnjë mjet tjetër juridik administrativ ose gjyqësor, ju keni gjithashtu të drejtën të paraqisni një ankesë pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse besoni se është shkelur ndonjë e drejtë që lidhet me mbrojtjen e të dhënave tuaja personale.

Më shumë informacion mund të gjeni në: <https://idp.al/> dhe <https://idp.al/kontakt/>

